Në mbështetje të nenit 11 dhe nenit 12, paragrafi 2, pika d), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008", e në mbështetje të nenit 8, lidhur me nenin 20, të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/2008", i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-108 "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2016", e konform nenit 29, paragrafi 2, pika (c) të Statutit te Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë ne mbledhjen e mbajtur me datën, ---------- miraton këtë:

Projekt-V E N D I M

Neni 1

1.1 Me këtë vendim caktohet tarifa ditore për tregun javor që shfrytëzohet për shitjen e produkteve nga tregtaret ambulantor si më poshtë;

1.1.1 Tavolinë e vogël do të paguaj shumën në vlerë prej (tri) 3.00€
1.1.2 Tezgë standarde do të paguaj shumën në vlerë prej (pesë) 5.00€
1.1.3 Hapësira për automjet dhe kombi do të paguaj shumën në vlerë prej (shtatë) 7.00€
1.1.4 Hapësira për kamion do të paguaj shumën në vlerë prej (nëntë) 9.00€
1.1.5 Hapësira për prodhuesit bujqësor deri në (gjashtë) 6m² do të paguaj shumën në vlerë prej (pesë) 5.00€

1.2 Çdo hapësirë shtesë ose hapësirë që nuk është si në piken 1.1.5 do të paguaj tarifën shtesë në vlerë prej 1 (një) euro për m².

Neni 2

Nëse tregtarët dëshirojnë të bëjnë pagesa vjetore sipas tarifave të përcaktuar sipas nenit 1, të këtij vendimi do të kenë zbritje 30%.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, përkatësisht Drejtoria për shërbime publike, emergjencë dhe Ndërmarrja publike lokale "Eko-Theranda" me seli në Suharekë.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr. 03/2026, për procedurat e shqyrtimit administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen zyrtare të Komunës.

K U V E N D I I K O M U N Ë S– S U H A R E K Ë

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit
_____
Mr.ec Bexhet KUÇI

Tregu javor ne qytetin e Suharekës

